



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Durrës, më 04.03.2025

**NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS**  
**Mbledhje e Radhës**

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

**NJOFTON:**

DITËN E HËNË, DATË 10.03.2025, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RADHËS, NË SALLËN E KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHKURT 2025
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SIPËRMARRËSIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE RRASHBULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS

Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 400 703.84 (KATËRQINDMIJË E SHTATËQIND E TRE, PIKË TETËDHJETË E KATËR) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION RRUGE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM”
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË RINDËRTIMIT TË PASHPENZUARA NË VITIN 2024, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2025
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDREQJES SË GABIMIT ME KARAKTER MATERIAL NË VKB-NË NR. 116, DATË 24.12.2024 “PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025”
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimin do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, nenit 34 pika 1, nenit 77 pika 8, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dorëzojnë propozimin e tyre (Raport/Procesverbal) mbi projektvendimin pranë zyrës së Sekretarit të Këshillit, sipas grafikut të mëposhtëm.

**Datë 07/03/2025**

Nr.	Komisionet që shqyrtojnë projektvendimet	Projektvendime pikat e rendit të ditës	Vendi i mbajtjes së mbledhjes	Ora
1.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	2, 3, 4,	Salla e Këshillit Bashkiak	11.00
2.	Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave	4	Salla e Këshillit Bashkiak	12.00

<b>3.</b>	Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit	<b>5</b>	Zyra e Sekretarit të Këshillit	<b>12.30</b>
<b>4.</b>	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	<b>2, 3</b>	Salla e Këshillit Bashkiak	<b>13.00</b>
<b>5.</b>	Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës,	<b>3</b>	Salla e Këshillit Bashkiak	<b>14.00</b>
<b>6.</b>	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit	<b>1</b>	Zyra e Sekretarit të Këshillit	<b>14.30</b>

**SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**

**Dorina Milja**